



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Kuvendi,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi I Republikës së Kosovës, në mbledhjet plenare të mbajtura më 1 dhe 7 qershor 2012, pas Debatit parlamentar lidhur me Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, nxori këto :

**REKOMANDIME**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, në afat sa më të shkurtër kohor, të hartojë Programin Kombëtar gjithëpërfshirës për shvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili do të garantojë zhvillimin e plotë të fëmijës, si një qytetar i dobishëm dhe produktiv për shoqërinë kosovare;
2. Të inkurajoj institucionet, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, duke siguruar burime njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e politikave të nevojshme në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen lidhur me zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë;
3. Të hartojë programe cilësore dhe educative për prindërit, me qëllim të përmirësimit të ushqyeshmërisë, kujdesit dhe stimulimit të të nxëniet në fëmijërinë e hershme, që do të ofrohen përmes shërbimeve shëndetësore, si maternitetet dhe qendrat e mjekësisë familjare në sektorin public dhe privat, në bashkëpunim me sektorin e arsimit dhe mirëqenies sociale;
4. Me qëllim të realizimit të të drejtave të fëmijëve, për zhvillimin e potencialit të plotë kognitiv, emocional, social, fizik dhe përgatitjen e nevojshme prapake për shkollë, të hartojë programe educative cilësore për prindër, educator dhe kujdestar, përmes shërbimeve që do të ofrohen nga institucionet e arsimit, në bashkëpunim me institucionet shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;

5 Të fuqizojë shërbimet sociale për mbrojtjen e fëmijës nga çfarëdo formë e dhunës, keqtrajtimit dhe eksploatimit, si dhe mbrojtja sociale përmes ofrimit të asistencës sociale për fëmijët në nevojë;

6. Të fuqizojë zbatimin e kodeve etike nga të gjitha institucionet dhe profesionistët të cilët punojnë drejtpërdrejtë me fëmijë, si dhe mediat, për të siguruar mbrojtjen nga cenimi i të drejtave të fëmijëve;

7. Të sigurojë që në procesin e riadhesimit, në mënyrë individuale të shqyrtojë çdo rast, duke marrë parasyshë interesin më të lartë të fëmijës, në mënyrë që të kenë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore, arsimore dhe sociale;

8. Të hartohet Projektligji për fëmijët.

Nr. 04-V-389

Prishtinë, më 7 qershor 2012

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

**Rekomandimet i dërgohen :**

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione
- Arkivit të Kuvendit.

